“Mos e vrit, se po e vrave, ai do të arrijë në pozitën që kishe ti para se ta vrisje, ndërsa ti do të vendosesh në pozitën që kishte ai para se t'i thoshte ato fjalë”, - tha i Dërguari i Allahut

Mikdad ibn Amër Kindiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i kishte thënë të Dërguarit të Allahut : "O i Dërguari i Allahut, nëse më ndodh të takoj një jobesimtar e të luftoj me të, ndërkohë më bie me shpatë e ma pret dorën, dhe pastaj mbrohet nga unë pas një peme dhe thotë: "I jam nënshtruar Allahut!" A ta vras, vallë, pasi ta thotë këtë?" - “Mos e vrit!” - tha i Dërguari i Allahut . - O i Dërguari i Allahut, ai më preu njërën dorë dhe ato fjalë i tha pasi ma preu dorën, e të mos e vras? - përsëriti Mikdadi. - “Mos e vrit, se po e vrave, ai do të arrijë në pozitën që kishe ti para se ta vrisje, ndërsa ti do të vendosesh në pozitën që kishte ai para se t'i thoshte ato fjalë”, - tha i Dërguari i Allahut ."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Mikdad ibn Esvedi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pyeti Profetin : Nëse unë takoj një njeri nga jobesimtarët në betejë dhe përballemi me shpatat tona, derisa jobesimtari të më godasë me shpatë dhe të më presë njërën dorë. Pastaj ky jobesimtar ikën prej meje dhe strehohet pas një peme, e më pas thotë: "La ilahe il-lallah", a më lejohet ta vras atë pasi ma ka prerë dorën?" Profeti i tha: "Mos e vrit!" Ai i tha: "O i Dërguari i Allahut! Ai ma preu njërën dorë, e megjithëkëtë të mos e vras?!" Profeti tha: "Mos e vrit, sepse ai tani e ka gjakun haram (është i mbrojtur nga vrasja). Nëse ti e vret pasi ai ka pranuar Islamin, atëherë ai është në pozitën tënde, i mbrojtur nga vrasja për shkak të Islamit të tij, ndërsa ti do të ishe në pozitën e tij, ku gjaku yt do të jetë i lejuar për hakmarrje (kisas)."

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4815